



**BASHKIA
TIRANË**

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 31, datë 05.04.2017

PËR

“MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË INVENTARIT TË PASURIVE SHESHE, TREGJE, POLIKLINIKA, TË NDËRMARRJES FUNERALE DHE TË DREJTORIVE TË PËRGJITHSHME NR. 1, 2 DHE 3 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT, QË JANË NËN JURIDIKSIONIN TERRITORIAL DHE ADMINISTRATIV TË BASHKISË TIRANË DHE KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE”

Në mbështetje të pikës 2, nenit 8, pikës 1/1.1, shkronja “b” dhe pikës 1/1.2 të nenit 9, nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); nenit 3 të Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit njësisive të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); pikës 6 dhe pikës 14, paragrafi i dytë i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); pikës 1, shkronja “a” të Udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pasurive sheshe, tregje, poliklinika, të Ndërmarrjes funerale dhe të Drejtorive të Përgjithshme nr. 1, 2 dhe 3 të Punëtorëve të Qytetit, që janë nën juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë, sipas listës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e kërkesës për transferimin përfundimtar të pasurive të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi nga Këshilli i Ministrave.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit dhe Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI